

VENDIM
Nr.94, datë 9.2.2011

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPENZIMEVE TË ZBRITSHME PËR MJEKIM, PËR VETE APO PËR FËMIJËT E PERSONAT NË KUJDESTARI, PËR PJESËN E PAMBULUAR NGA SIGURIMI I DETYRUESHËM SHËNDETËSOR, E PËR DEKLARATËN PERSONALE TË TË ARDHURAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13/3 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpenzimet vjetore që një tatimpagues bën për mjekim, për vete, për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, që njihen si shpenzim i zbritshëm në bazë të shkronjës “c” të nenit 13/3 “Shpenzimet e zbritshme”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, janë 8 532 (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë.

2. Në rast të plotësimit të deklaratës nga kryefamiljari, bazuar në pikën 4 të nenit 13/1 të ligjit, shpenzimet vjetore për mjekim, për vete apo për fëmijët e personat në kujdestari për pjesën e pambuluar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, janë 8 532 (tetë mijë e pesëqind e tridhjetë e dy) lekë për secilin anëtar të familjes, por jo më shumë se 32 000 (tridhjetë e dy mijë) lekë.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për nxjerrjen e udhëzimit, në zbatim të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha